REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Nr.4988 prot **Maliq, më 11.09.2025**

Lënda: *Mbi auditimin e KLSH dërguar me shkresën nr.1086/6, datë 25.06.2025.*

KËSHILLIT TË BASHKISË

Të nderuar këshilltarë të Këshillit Bashkiak në zbatim të Ligjit nr.139/2015"*Për vetëqeverisjen vendore*" neni 43 "*Kontrolli i jashtëm dhe auditimi*" ju bëj me dije se Bashkia Maliq i është nënshtruar rregullisht kontrollit të jashtëm nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit.
Me shkresën nr.1086/6 prot. Datë 25.06.2025 është dërguar Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet për auditimin e ushtruar në Bashkia Maliq "*Mbi auditimin Financiar*".

Në auditimin e fundit nga grupi i KLSH u auditua gjithsej një vit dhe konkretisht 01.01.2023 deri më datën 31.12.2023.

Po ju japim të dhënat e Raportit Përfundimtar dhe Rekomandimet që ka lënë KLSH në këtë material.

- ✓ **Opinioni i Auditimit të kryer nga KLSH:**
  - ➢ Opinioni i Pasqyrave financiare të vitit 2023.

Sipas opinionit të audituesve të KLSH, pasi kanë marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, shprehim një opinion të **modifikuar/kualifikuar** për llogaritë vjetore të subjektit Bashkia Maliq, duke arritur në përfundim se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapura, në llogaritë vjetore të vitit 2023, të shprehura në bazën për opinion.
Në këtë drejtim janë konstatuar disa çështje teknike të kontabilitetit për të cilat Drejtoria e Financës dhe Buxhetit ka bërë observacionet përkatëse dhe në përfundim është rënë dakort mbi pozicionet e llogarive përkatëse.

Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe çdo auditim punën e mirë e thotë me dy fjalë dhe më pas trajtojnë vetëm parregullshmëritë dhe problematikat e konstatuara me synim ndreqjen e tyre dhe përmirësimin e punës në të ardhmen.

- ✓ Në materialin e dhënë në Raportin Përfundimtar KLSH për përmirësimin e gjendjes ka rekomanduar marrjen e masave të mëposhtme:

- ✓ Në mënyrë të përmbledhur janë dhënë gjithsej 31 rekomandime nga 33 rekomandime të dhëna në auditimin e mëparshëm, nga të cilat:

- ➢ *Masa organizative* janë dhënë 19 nga 27 rekomandime të dhëna në auditimin e mëparshëm;
- ➢ *2-Masa shpërblim dëmi* nuk ka, në auditimin e mëparshëm ishin 2 rekomandime;
- ➢ 3-*Masa për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet,eficencë dhe efektivitet të fondeve publike të lëna në auditimin e mëparshëm* 2 rekomandime .
- ➢ *Masa për uljen e borxhit tatimor* për të rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim-taksat vendore 10 rekomandime nga 4 rekomandime në auditimin e mëparshëm.

Siç shihet dhe nga numuri i gjetjeve dhe rekomandimeve të dhëna rezulton se nga 31 në total prej tyre janë të karakterit organizativ ose 61 % dhe vetëm 2 gjetje dhe rekomandime janë me efekte negative, si dhe 10 gjetje janë për uljen e borxhit tatimor dhe 1 rekomandim për 8 masa disiplinore për punonjësit e Bashkisë.

- ✓ **Vetë natyra e gjetjeve dhe rekomandimeve dhe raporiti i tyre tregon që Bashkia Maliq nuk është një subjekt problematik për Kontrollin e Lartë të Shtetit.**

I. MASA ORGANIZATIVE

Në total janë konstatuar gjetje dhe janë dhënë rekomandime gjithsej 19:

Rekomandimi nr.1 Kryetari i Bashkisë Maliq, strukturat përgjegjëse të marrin masa për të ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollin e brendshëm, duke hartuar një kuadër të plotë rregullash për këtë qëllim. Strukturat drejtuese të ndjekin nivelin e implementimit të komponentëve të MFK-it për plotësimin e mangësive të konstatuara nga grupi i audituimit.

-Ky rekomandim është dhënë mbas gjetjes nga KLSH pasi kane konstatuar mangësi teknike që kanë të bëjnë me MFK, mangësi të cilat janë rutinë e punës së përditëshme të institucione.

Rekomandimi nr.2 Kryetari i Bashkisë Maliq, drejtuesi i NJAB të marrin masa për të hartuar dhe miratuar "*Kartën e Auditit të Brendshëm*", të respektojnë kriteret e miratuara mbi hartimin e planeve strategjike dhe vjetore, bazuar në problematikën e trajtuar në gjetje.

-Ky rekomandim është dhënë mbas gjetjes nga KLSH pasi kanë konstatuar se nuk është përditësuar për çdo vit miratimi i Kartës së Auditimit të Brendshëm dhe nuk ka përfshirë në plan auditimin e veprimtarisë së disa sektorëve me rrisk të lartë(*sistemi i pagave dhe prokurimeve*). Ligji për auditimin e brendshëm në nënin 4 pika 12 shprehimisht thuhet. "*Karta e Auditimit është një akt administrativ që miratohet me urdhër të titullarit të njësisë publike, në të cilën përcaktohen statusi organizativ, qëllimi, misioni, objektivat e punës, përgjegjëshmëria dhe përgjegjësitë e njësosë së auditimit të brendshëm*" Nga ana e institucionit tonë Karta e Auditimit të Brendshëm është miratuar me urdhërin e Kryetarit të Bashkisë nr.325, datë 24.06.2022, struktura e NJAB nuk ka patur ndryshime dhe kërkesat e ligjin nuk janë të përditësohet për çdo vit. Prokurimet janë në proces auditimi këtë vit dhe vitet e tjera nuk janë audituar pasi për çdo vit ato janë audituar nga KLSH.

Rekomandimi nr.3 Bashkia Maliq, përmes Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit, të marrë masa për forcimin e planifikimit dhe programimit buxhetor, duke u bazuar në parashikime reale dhe analiza të detajuara të shpenzimeve kapitale dhe operative në fillim të çdo viti buxhetor, me qëllim parandalimin e krijimit të detyrimeve të prapambetura…

-Ky rekomandim është dhënë mbas gjetjes nga KLSH lidhur me planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit ku është konstatuar se: Gjatë hartimit të PBA-së për vitet 2023-2025, nuk është marrë në konsideratë stoku i detyrimeve të papaguar ndaj të tretëve,të cilat i përkasin periudhave të mëparëshme. Theksojmë se Bashkia Maliq nuk është në instucionet problematike për Ministrinë e Finacave për detyrimet e prapambetura .

Rekomandimi nr.4 Bashkia Maliq, përmes Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit, të marrë masa të menjëhershme për analizimin, evidentimin dhe saktësimin e vlerave të detyrimeve progresive të prapambetura duke siguruar që ato të raportohen në vlerë reale pranë Ministrisë së Financave…

-Ky rekomandim është dhënë në vijim të gjetjes së konstatuar lidhur me detyrimet e prapambetura dhe kontabilizimin në llogarinë 467 "*Kreditorë të ndryshëm*". Lidhur me çështjet teknike të kontabilizimit të kësaj llogarie nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit janë bërë observacionet përkatëse pasi dhe specialistë të ndryshëm në grupe të ndryshme të KLSH kanë mendime të ndryshme.

Rekomandimi nr.5 Drejtoria e Financës dhe e Buxhetit të marrë masa për të siguruar raportimin e saktë të detyrimeve të prapambetura, të cilat lidhen me fondet nga Ministria e Linjës për realizimin e investimeve, me qëllim rakordimin e vlerave për përfundimin e kontratave përkatëse.

-Ky rekomandim është dhënë në vijim të gjetjes së konstatuar lidhur me fondet e përfituara përmes FZHR dhe FZHSH dhe ministritë e linjës, pasi sipas KLSH fondet e paçelura nga këto institucione të paraqiten si detyrime të prapambetura, ndërsa institucioni jonë ka zbatuar saktësisht udhëzimin e ministrisë për raportimin e detyrimeve të prapambetura vetëm bazuar në faturat e prera dhe kalimit të afatit 60 ditor për likujdim.

Rekomandimi nr. 6 Kryetari i Bashkisë Maliq dhe Drejtoria e Financës dhe e Buxhetit të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime realiste. Mbi bazën e ktyre të ardhurave të parashikohet edhe plani i investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurta për t'u realizuar. Për mosrealizimin gjatë vitit buxhetor të të ardhurave të planifikuara, të korrigjohet plani i shpenzimeve, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi.

-Ky rekomandim është dhënë në vijim të gjetjes së konstatuar lidhur me realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore. Në periudhat në vijim nga ana e institucionit tonë do të merret në konsideratë duke bërë planifikime më realiste duke u mbështetur në realizimin e viteve të mëparshme si dhe në analizën reale të situatës financiare. Për çdo vit nga ana e jonë bëhet korigjimi i planit të shpenzimeve bazuar në realizimet përkatëse, veprime këto që bëhen në afatet ligjore dhe për çdo rast të ndryshimit të buxhetit kemi paraqitur materialet përkatëse në Këshillin e Bashkisë.

Rekomandimi nr.7 Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Drejtorinë e të Ardhurave nga Taksat dhe Tarifat Vendore, të marrë masa për ristrukturimin dhe plotësimin e organikës së kësaj drejtorie, në përputhje me natyrën funksionale të administrimit të të ardhurave vendore. Në këtë kuadër, të krijohen njësi të posaçme si "Sektori i Menaxhimit të Borxhit Tatimor", dhe "Sektori i Regjistrimit të unifikuar të Subjekteve tatimpagues", si edhe të organizohet dhe të vihet në funksion struktura e apelimit administrativ për shqyrtimin e ankesave tatimore. Paralelisht DATTV të ndërmarrë masa për përmirësimin e procesit të njoftimit në kohë të subjekteve për detyrimet e tyre tatimore, duke garantuar respektimine të gjitha etapave proceuriale ligjore dhe administrative, me qëllim shmangien e pasojave të mundshme financiare apo ligjore për institucionin.

-Ky rekomandim është dhënë në vijim të gjetjes së konstatuar lidhur me funksionimin e Drejtorisë së të Ardhurave nga Taksat dhe Tarifat Vendore. Kjo do të merret në konsideratë nga ana e jonë në periudhat në vijim pasi aktualisht jemi duke eksperimentuar vjeljen e taksave dhe tarifave vendore me agjentë tatimor dhe kryesisht Ndërmarjen e Ujësjellës-Kanalizimeve.

Rekomandimi nr.8 Nga Bashkia Maliq të merren masa për organizimin e strukturës së "Paketës Fiskale", për unifikimin e evidencave të raportimit, strukturës së regjistrit elektronik të subjekteve të DATTV me strukturën e Paktës fiskale të miratuar si edhe të merren masa që të gjitha strukturat e ngarkuara me administrimin e taksave vendore, të koordinojnë punën me institucionet e ndërlidhura me qëllim shkëmbimin e informacioneve në kohë reale për të shmanguar problematikat e konstatuara.

-Ky rekomandim është dhënë në vijim të gjetjes së konstatuar lidhur me funksionimin e Drejtorisë së të Ardhurave nga Taksat dhe Tarifat Vendore për paketën fisklale që miratohet çdo vit. Paketa fiskale që paraqitet për miratim bashkë me buxhetin për çdo vit që vjen duke u përmirësuar dhe plotësuar me të gjitha detajet e nevojshme.

Rekomandimi nr.9 Strukturat drejtuese të Bashkisë Maliq, duke vlerësuar kohën, burimet njerëzore dhe financiare të nevojshme, të ndërrmarin masa për ngritjen e një sistemi të unifikuar për grumbullimin, përpunimin, ruatjen dhe analizimin e informacionit, si edhe për gjenerimin e raporteve të sakta dhe në

kohë për subjektet që ushtrojnë aktivitet në territorin e saj, ne funksion të rritjes së efektivitetit dhe sigurisë institucionale. Të përmirësohet struktura ekzistuese e teknologjisë dhe informacionit (IT), duke e ngritur atë nga nivel sektori, në nivel Drejtorie, në përputhje me nevojat e sistemit. Po ashtu të caktohet një person përgjegjës dhe i autorizuar për administrimin e të dhënave, dhe të garantohet që ky sistem të përfshijë edhe mekanizma të auditimit dhe analizës së të dhënave. Paralelisht Bashkia duhet të ndërtojë edhe një program për sigurinë e të informacionit, i cili të përfshijë të gjithë komponëntët përkatës në përputhje me udhëzimet dhe miratimin nga AKSHI dhe Komisioneri për mbrojtjen e të dhënave personale.

-Ky rekomandim është dhënë në vijim të gjetjes së konstatuar lidhur me funksionimin e Drejtorisë së të Ardhurave nga Taksat dhe Tarifat Vendore dhe konkretisht për mbajtjen dhe evidentimin e taksave dhe tarifave për familjarët që aktualisht mbahen në mënyrë elektronike në formatin excel. Jemi duke marrë masat që të instalojmë një program elektronik me synim përmirësimin e punës në këtë drejtim.

Rekomandimi nr.10 Bashkia Maliq të marri masa për unifikimin e strukturës së regjistrit elektronik të subjekteve të DATTV me strukturën e Paketës Fiskale, të marri masa për hartimin e një rregulloreje të brendshme për monitorimin e procesit të grumbullimit përpunimit dhe ruajtjes së informacionit dhe gjenerimit të raporteve të sakta dhe në kohë për subjektet që ushtrojnë aktivitet në bashkinë Maliq, si edhe të marri masa për krijimin e një strukture për monitorimin dhe dokumentimin mbi ndryshimet që ndodhin në lidhje me ngarkesat dhe pagesat për detyrimet mbi taksat dhe tarifat vendore.Procesverbalet mbi ndryshimet që ndodhin të administrohen në dosjet e subjekteve.DATTV të bashkëveprojë me burimet njerëzore për ndjekjen e të gjitha procedurave për përdorues të cilët janë punësuar rishtas, larguar nga detyra apo kanë ndryshuar pozicion në strukturën organizative lidhur me ruajtjen e të dhënave personale në regjistrin elektronik që ata kanë marrë në administrim.

-Ky rekomandim është dhënë në vijim të gjetjes së konstatuar lidhur me funksionimin e Drejtorisë së të Ardhurave nga Taksat dhe Tarifat Vendore dhe konkretisht për mbajtjen dhe evidentimin e taksave dhe tarifave për subjektet private që ushtrojnë aktivitet ne teritorin e bashkisë. Në programin elektronik që do blejmë se shpejti do të përfshihet dhe evidentimi i subjekteve private.

Rekomandimi nr.11 Bashkia Maliq, strukturat e ngarkuara për administrimin e taksave dhe tarifave vendore të marrin masa që për të gjitha subjektet që ushtrojnë aktivitet në territorin e saj të rakordojnë nëpërmjet sektorit të verifikimeve në terren informacion e paraqitur vullnetarisht nga subjektet pranë sporteleve apo QKB dhe DRT Korcë.
-Të ushtrohet kontroll në të gjitha subjektet për llogaritjen e detyrimeve tatimore, mbajtjen e regjistrave dhe kryerjen e pagesavet ë tatimeve në përputhje me procedurat dhe afatet e përcaktuara në legjislacionin tatimor.
-Të përllogariten detyrimet tatimore bazuar në paketën fiskale të miratura në vite dhe nëse dalin diferenca të planifikohen për tu arkëtuar.
-Të evidentojë subjektet që ushtrojnë aktivitet pa leje dhe të merren masat përkatëse ligjore për regjistrimin e tyre dhe llogaritjen e arkëtimin e detyrimeve përkatëse.
-Akt konstatimet e mbajtura nga sektori i kontrollit ne terren të realizohen konform kuadrit rregullator ligjor, brenda afateve të përcaktuara ligjore.
-Vlerësimi për detyrimin tatimor vjetor, ndryshimi i të dhënave për ngarkesën fiskale vjetore apo ndalimi i faturimit, të bëhet bazuar në akt kontrollet e sektorit të terrenit, statusin e subjektit në QKB apo në rakordimin me DRT.
-Në të gjitha dosjet e subjekteve tatimpagues të administrohet Aktet e kontrollit të mbajtura nga sektori i kontrollit në terren.
-Në regjistrin elektornik të administrohen shënime apo evidenca që pasqyrojnë ndjekjen e procedurave ligjore për mbledhjen e debisë së subjekteve si edhe të dokumentohen ndrysjimet mbi historikun e subjektit. Për të gjitha subjektet të cilat kanë adresë dytësore, në fushën e adresës dytësore të përcaktohet numri serial që lëshohet nga DRT për adresat dytësore.

-Ky rekomandim është dhënë në vijim të gjetjes së konstatuar lidhur me funksionimin e Drejtorisë së të Ardhurave nga Taksat dhe Tarifat Vendore të gjitha problematikat e trajtuara në këtë rekomandim i janë lënë për zbatim kësaj drejtorie për periudhën në vijim.

Rekomandimi nr.12 Bashkia Maliq të marrë masa që metodologjia e përdorur për planifikimin vjetor mbi të ardhurat të jetë e bazuar në pritshmëritë reale të ktij institucioni, duke marrë parasysh mosrealizimet ose tejkalimet e të ardhurave të viteve të mëparshme. Strukturat përgjegjëse për administrimin e taksave dhe tarifave vendore të marrin masa për të dokumentuar analiza të detajuara lidhur me mosrealizimin e vazhdueshëm të të ardhurave nga burimet e veta duke u mbështetur në raportime dhe plane konkrete pune për realizimin e të ardhurave me qëllim shmangien e krijimit të deficitit në të ardhurat e arkëtuara.

-Ky rekomandim është dhënë në vijim të gjetjes së konstatuar lidhur me funksionimin e Drejtorisë së të Ardhurave nga Taksat dhe Tarifat Vendore të gjitha problematikat e trajtuara në këtë rekomandim i janë lënë për zbatim kësaj drejtorie për periudhën në vijim.

Rekomandimi nr.13 Bashkia Maliq, Drejtoria e Financës dhe e Buxhetit në mbyllje të procedurës vjetore të inventarizimit të aktiveve:
-Të planifikojë për periudhat në vazhdim, fonde për procedurën e rivlerësimit të aseteve, me qëllim pasqyrimin e tyre me vlerën reale në llogaritë kontabël përkatëse të bilancit.
-Të hartojë dhe miratojë *"Regjistrin e Aktiveve"* bazuar në vlerësime reale të nevojshme për përcaktimin e vlerës së Asetit sipas kërkesave ligjore.
-Të përfshijë në *"Regjistrin e Aktiveve"* gjithë asetet e transferuara sipas VKM-ve dhe ato nga "Ish Komunat" sipas klasifikimit të Llogarive Kontabël. Strukturat përgjegjëse të marrin masat për përshpejtimin e procedurave të pajisjes me titull pronësie të tyre.

-Ky rekomandim është dhënë në vijim të gjetjes së konstatuar lidhur me asetet, në vijim do të planifikohen dhe fonde për të realizuar rivlerësimin e të gjitha aseteve të Bashkisë.

Rekomandimi nr.14 Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të analizopjë dhe të sistemojë llogarinë 4342 "Operacione me shtetin (të drejta) e cila është nënvlerësuar për shumën 55,225,191 lekë:
-Të llogarisë amortizimin e llogarisë 202 "Studime dhe kërkime" dhe të sistemojë vlerën e amortizimin për secilin vit në pasyqrat financiare 2018.
-Të sisitemojë llogarinë 213"Rrugë, rrjete, vepra ujore", për 6 objektet e ndërtuara në vitin 2015 për të cilat llogaria 212 është e mbivlerësuar për shumën 7,137,488 lekë.
-Të planifikojë në buxhet fonde për procedurën e rivlerësimit të 7 objekteve të hershme të llogaria 212"Ndërtesa e konstruksione", në vlerë kontabël të vogël të paindeksuar prej 215,820 lekë me qëllim pasëyrim ne vlerë reale të tyre ne PF.
-Të sistemojë llog 212 "Ndërtesa e konstruksione", për 14 objektet e investuara në 2015 për të cilat llog 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore", është mbivlerësuar për shumën 11,993,111 lekë.
-Të sistemojë llog 218/6 „"Pajisjje kompjuterike" për 24 aktivet. Me kalimin e ktyre aktiveve në këtë llog të rillogaritet amortizimi për secilin vit në PF nga viti2018 e në vijim me normën e amortizimit 25% për një pasqyrim real të vlerës neto të aktivit.
-Në llogarinë 218 "Inventari ekonomik" të klasifikojë veçmas llogarine 218/6 në regjistrin e aseteve dhe PF konform kërkesave të nomeklaturës së llogarive,
-Të llogarisë amortizimin sipas normës përkatëse për çdo aktiv.
-Të hartojë Pf të konsoliduara, ku të përfshihen edhe pasqyrat financiare të njësive në vartësi me qëllim pasqyrimin e plotë dhe transaprent të të ardhurave dhe shpenzimeve si dhe shpërndarjes së tyre sipas zërave.

-Ky rekomandim është dhënë në vijim të gjetjes së konstatuar lidhur me funksionimin e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit të gjitha problematikat e trajtuara në këtë rekomandim i janë lënë për zbatim kësaj drejtorie për periudhën në vijim.

Rekomandimi nr.15 Në Bashkinë Maliq, GMS, Drejtoria e Urbanistikës dhe Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë Jurdike të marrin masa konkrete për zhbllokimin e Llogarisë 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje" vecanërisht për 26 projekt investimet e hershme të trasheëguara nga komunat për vlerën tot prej 1,876,017 lekë.

-Ky rekomandim është dhënë në vijim të gjetjes së konstatuar lidhur me funksionimin e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit të gjitha problematikat e trajtuara në këtë rekomandim i janë lënë për zbatim kësaj drejtorie për periudhën në vijim.

Rekomandimi nr.16 Drejtoria e Financës dhe e Buxhetit në bashkëpunim me Drejtorine e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masat që veprimet me arkën dhe bankën të kryehn sipas kërkesave të kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi.

-Ky rekomandim është dhënë në vijim të gjetjes së konstatuar lidhur me funksionimin e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit të gjitha problematikat e trajtuara në këtë rekomandim i janë lënë për zbatim kësaj drejtorie për periudhën në vijim.

Rekomandimi nr.17 Bashkia Maliq në bashkëpunim me DVASHK Korcë të kryejë identifikimin e pronave të regjistruara në kufizimm dhe të ndjekë anën ligjore për zgjidhje të problematikave të kontatuara si dhe të kryejë saktësimin e inventarit të pasurive të transferuara në pronësi apo në përdorim të Bashkisë Maliq.

-Ky rekomandim është dhënë në vijim të gjetjes së konstatuar lidhur me transferimin e fondit pyjor. Eshtë lënë detyrë për zbatim strukturave përkatëse.

Rekomandimi nr.18 Sektori i Pyejeve/Kullotave pranë Bashkisë Maliq në respektim të procedurave ligjore të zbatojë kriteret teknike gjatë procesit të dhënies në përdorim të kullotave, të plotësojë dosjet e subjekteve me dokumentat e nevojshëm për ata që kanë kontratë aktive, duke përfshirë të dhenat e kërkuesit si dhe certefikatat veterinare të lëshuara cdo vit nga shërbimi veterinar. Sektori i Pyje Kullotave për të gjitha kontratat e qiradhënies për sipërfaqet e kullotave për ndërtime të përkohëshme, të kryejë verifikimin dhe monitorimin e planit të rehabilitimit për subjektet që do të përdorin sipërfaqet e kullotave për ndërtime të përkohshme. Në dosjet e administruara për këto subjekte të arkivohen procesverbalet gjatë lidhjes së kontratës, periudhave të monitorimit të saj dhe në përfundim për marrjen në dorëzim të pasurive.

-Ky rekomndim është dhënë në vijim të gjetjes së konstatuar lidhur me Sektorin Pyjor është lënë detyrë për zbatim në vijimësi.

Rekomandimi nr.19. Në këtë rekomandim janë analizuar detyrat e lëna nga auditimin e mëparshëm dhe janë lënë detyra zbatimi i rekomandimeve në proces zbatimi dhe ato të pazbatuara.

-Nga institucioni jonë vazhdon ndjekja e vazhdueshme e zbatimi i rekonadimeve të lëna për të gjitha periudhat.

C.MASA PËR ELEMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM.

Rekomandimi nr.1 Kryetari i Bashkisë Maliq, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës me qëllim rakordimin e numrit dhe të sipërfaqeve të subjekteve për kryerjen e planifikimit dhe arkëtimin e të ardhurave nga tarifa për mbrojtje nga zjarri, bazuar në paketat fiskale të miratuara në vite dhe pritshmëritë reale që ky intistucion ka për realizimin e të ardhurave nga kjo tarifë.

-Ky rekomandim është dhënë në vijim të gjetjes së konstatuar lidhur me tarifën për mbrojtjen nga zjarri. Për këtë nga Kryetari i Bashkisë është ngritur një grup pune me specialistë të fushës me qëllim rakordimin e numrit dhe sipërfaqeve të subjekteve me synimin e një planifikimi sa më real.

Rekomandimi nr.2 Nga Kryetari i Bashkisë të ngrihet një grup pune me specialistët e fushës me qëllim rakordimin e numrit të familjeve mbi të cilat planifikohet ky shpenzim në zonat që mbulohen me këtë shërbim sipas përcaktimeve në kontratën me OE. Në rast se nga procesi i verifikimit konstatohen diferenca midis tyre sipas zonave të qytetit të kërkohet bazuar në vlera konkrete planifikimi i saktë për këtë zë dhe arkëtimi i diferencave duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme në rrugët administrative dhe ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit.

-Ky rekomandim është dhënë në vijim të gjetjes së konstatuar lidhur me planifikimin e tarifës së pastrimit. Nga ana e Bashkisë janë bërë kontestimet e nevojshme megjithatë nga Kryetari i Bashkisë janë marrë masat për ngritjen e një grupi pune me specialistët e fushës me qëllim rakordimin e numurit të familjeve mbi të cilat planifikohen shpenzimet në zonat që mbulohen me këtë shërbim sipas përcaktimeve në kontratën me operatorin ekonomik.

D. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR, PËR RRITJEN E PERFORMANCËS NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA.

Rekomandimi nr.1 Bashkia Maliq, Drejtoria e të Ardhurave dhe DPKZHT të marrin masat të ndjekin të gjitha rrugët administrative ligjore për arkëtimin e detyrimit në vlerën 9,381 lekë për taksën e ndërtesës nga 3 subjekte që janë pajisur me certefikata përdorimi.
Bashkia Maliq Drejtoria e të ardhurave të marrin masta dhe të ndjekin të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e shumës 119,340 lekë nga 19 subjekte që rezultojnë me statusin aktiv në QKB por për vitin 2023 nuk kanë paguar detyrimin tatimor për taksën e ndërtesës për Sip Totale prej 1,105 m^2.
Bashkia Maliq Drejtoria e të ardhurave të marrin masat dhe të ndjekin të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës 152,377 lekë për 13 subjekte për të cilat vlerësimi tatimor për taksën e dnërtesës në regjistrin elektronik për vitin 2023 ka diferencë nga sipërfaqja faktike për 1,410.9 m^2.

-Ky rekomandim është dhënë në vijim të gjetjes lidhur me arkëtimin e tarifave nga subjektet private. Për këtë Kryetari i Bashkisë në urdhërin nr.374, datë 22.7.2025 ka udhëruar arkëtimin e plotë të vlerës të përcaktuar në raportin final për çdo rast dhe subjekt.

Rekomandimi nr.2 Bashkia Maliq Drejtoria e të Ardhurave të marrin masat dhe të ndjekin të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës 204,636 lekë nga 13 subjekte për diferencën nga sipërfaqja faktike për 17,053 m^2.
-Bashkia Maliq të marri masat për ngritjen e strukturave të nevojshme në mënyrë që të identifikojë çdo individ, person fizik ose juridik vendas ose i huaj pronar apo përdorues i pasurive të paluajtshme në

territorine saj si edhe të planifikoje detyrimin për pagimin e taksës për pasurinë e paluajtshme"Ndërtesë" apo "Truall"sipas rastit, pronari osë bashkëpronari sipas pjesës që zotëron për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokumente të pronësisë. DATTV të ndjekë të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura.

-Ky rekomandim është dhënë në vijim të gjetjes lidhur me arkëtimin e tarifave nga subjektet private. Për këtë Kryetari i Bashkisë në urdhërin nr.374, datë 22.7.2025 ka udhëruar arkëtimin e plotë të vlerës të përcaktuar në raportin final për çdo rast dhe subjekt.

Rekomandimi nr.3 Bashkia Maliq, Drejtoria e të Ardhurave të marrin masat dhe të ndjekin të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës 2,412,300 lekë nga 12 subjekte për detyrimin mbi vlerësimin tatimor në vitin 2023 paraqitur në aneksin nr.1 Rap. Perf konkretisht : Taksa e tabelës elektronike për 97 m^2 në vlerën 1,243,500 lekë dhe taksa e tabelës për reklamim për 86.58 m^2 në vlerën 1,168,830 lekë.

-Ky rekomandim është dhënë në vijim të gjetjes lidhur me arkëtimin e tarifave nga subjektet private. Për këtë Kryetari i Bashkisë në urdhërin nr.374, datë 22.7.2025 ka udhëruar arkëtimin e plotë të vlerës të përcaktuar në raportin final për çdo rast dhe subjekt.

Rekomandimi nr.4 Bashkia Maliq, Drejtoria e të Ardhurave të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e tarifës së pastrim, ndricim, gjelbërim për vitiin 2023 për vlerën 715,935 lekë ndaj 31 subjekteve paraqitur në Rap.Perf.
Bashkia Maliq të marrë masat e duhura që të përcaktojë në rregulloren e brendshme të saj detyrimin që të gjitha drejtoritë të cilat janë të angazhuara sipas paketës fiskale për administrimin dhe vjeljen e të ardhurave të raportojnë në mënyrë periodikedhe të bëjnë rakordimet me DATTV.

-Ky rekomandim është dhënë në vijim të gjetjes lidhur me arkëtimin e tarifave nga subjektet private. Për këtë Kryetari i Bashkisë në urdhërin nr.374, datë 22.7.2025 ka udhëruar arkëtimin e plotë të vlerës të përcaktuar në raportin final për çdo rast dhe subjekt.

Rekomandimi nr.5 Bashkia Maliq, DPKZHT të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimine taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje, por në proces legalizimi në vlerën 12,903,166 lekë ndaj 332 subjekteve.

-Ky rekomndim është dhënë në vijim të gjetjes lidhur me arkëtimin e taksës së infrastrukturës nga subjektet private. Për këtë Kryetari i Bashkisë në urdhërin nr.374, datë 22.7.2025 ka udhëruar arkëtimin e plotë të vlerës të përcaktuar në raportin final për çdo rast dhe subjekt.

Rekomandimi nr.6 Bashkia Maliq, Drejtoria e Pronave Publike të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së tokës bujqësore në vlerën 34,806,266 lekë për 10,483 familjet e trajtuara me tokë bujqësore.

-Ky rekomandim është dhënë në vijim të gjetjes lidhur me arkëtimin e taksës së tokës nga familjarët. Për këtë Kryetari i Bashkisë në urdhërin nr.374, datë 22.7.2025 ka udhëruar arkëtimin e plotë të vlerës të përcaktuar në raportin final për çdo familje.

Rekomandimi nr.7 Bashkia Maliq të marrë masa që të pajisë të gjitha subjektet me licensa për tregëtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet vajra lubrifikante dhe lëndë djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë dhe të arkëtojë tarifat për 4 subjekte për diferencën debitore prej 3,400,000 lekë. Bashkia Maliq të marrë masa që të pajisë me leje "Non Stop" të subjekteve

që ushtrojnë aktivitet për 24 orë dhe të arkëtojë tarifat për 11 subjektet e konstatuara që nuk kanë bërë pagesa për këtë zë, për diferencën debitore prej 165,000 lekë.

-Ky rekomandim është dhënë në vijim të gjetjes lidhur me subjektet që tregëtojnë karburant me pakicë. Për këtë Kryetari i Bashkisë në urdhërin nr.374, datë 22.7.2025 ka udhëruar arkëtimin e plotë të vlerës të përcaktuar në raportin final për çdo rast dhe subjekt.

Rekomandimi nr.8 Bashkia Maliq të marrë masa që të plotësojë me dokumentacionin e nevojshëm të gjitha dosjet e kontratave për dhënien me qira të aseteve që administron dhe ato të ardhshme, konkretisht mbi procesin e regjistrimit të aseteve, procesin e dorëzimit të asetit dhe monitorimit mbi zbatueshmërinë e kushteve të kontratës dhe marrjes në dorëzim të asetit.

-Ky rekomandim është dhënë në vijim të gjetjes lidhur me objektet me qira. Për këtë Kryetari i Bashkisë në urdhërin nr.374, datë 22.7.2025 ka udhëruar arkëtimin e plotë të vlerës të përcaktuar në raportin final për çdo rast dhe subjekt.

Rekomandimi nr.9 Bashkia Maliq të marri masa për bashkëpunim me agjentët tatimorë mbi vjeljen e detyrimeve fiskale për kategorinë "familjar". Ky institucion të ngrejë grupe pune dhe të kordinojë procesin për evidentimin e 7,761 familjeve të cilat nuk kanë shlyer detyrimet për taksa e tarifa lokale duke rakorduar informacionin mbi familjet e regjistruara sipas regjistrit të gjendjes civile me situatën faktike në terren si dhe ndjekjen e të gjitha procedurave ligjore për arkëtimine të ardhurave në vlerën 18,465,000 lekë.

-Ky rekomandim është dhënë në vijim të gjetjes lidhur me taksat familjare. Për këtë Kryetari i Bashkisë në urdhërin nr.374, datë 22.7.2025 ka udhëruar arkëtimin e plotë të vlerës të përcaktuar në raportin final për çdo familje.

Rekomandimi nr.10 Bashkia Maliq strukturat përgjegjëse sipas përcaktimeve në paketën fiskale dhe strukturën organizative të marrin masat administrative duke ndjekur rrugët administrative për arkëtimin e detyrimeve debitore në vlerën 109,095,835 lekë, kjo për 12,650 subjekte dhe abonentë familjarë për të bërë të mundur rritjen e performancës dhe uljen e borxhit të keq që mund të krijohet nga mosndjekja e tyre.

-Ky rekomandim është dhënë në vijim të gjetjes lidhur me debitorët. Për këtë Kryetari i Bashkisë në urdhërin nr.374, datë 22.7.2025 ka udhëruar arkëtimin e plotë të vlerës të përcaktuar në raportin final për çdo rast.

E.MASA DISIPLINORE
E.1 PËR PUNONONJËSIT TË CILËT JANË PJESË Ë SHËRBIMIT CIVIL.

I rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Maliq që për të gjithë punonjësit e trajtuar me përgjegjësi dhe me shkelje në Raportin Përfundimtar të Auditimit nga KLSH-ja bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve të fillojnë procedurat për masat disiplinore për 8 punonjës pjesë të shërbimit civil.

Ka filluar procedura e marrjes se masave disiplinore për 8 punonjësit, janë ngritur komisionet përkatëse vazhdohet me pocedurat e ankimimit dhe më pas komisionet do të dalin me vendimet përkatëse.

- ✓ Kryetari i Bashkisë në vijim, bazuar në Ligjin nr.139//2015 datë 17.12.2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" dhe rekomandimeve të lëna nga KLSH, ka nxjerrë Urdhërin nr.374, datë 22.04.2025 "Për Zbatimin e Raportit përfundimtar të auditimit të KLSH".

- ✓ Në urdhër janë marrë në konsideratë të gjitha rekomandimet e lëna dhe për vërejtjet për punonjësit është ngarkuar komisioni i shërbimit civil për ti marrë masat e nevojshme në vijim.

- ✓ Në përfundim bazuar dhe në raportin përfundimtar të auditimit të hartuar nga KLSH, problematikat e konstatuara janë të karakterit teknik dhe organizativ për të cilat po merren masat për përmirësimin e tyre në të ardhmen.

- ✓ Nuk ka asnje pikë në Raportin Përfundimtar me Dëm Ekonomik apo masa të tjera ndaj punonjësve dhe kjo është shumë e rëndësishme

- ✓ Është kërkuar nga të gjitha punonjësit dhe strukturat e bashkisë të kenë parasysh në punën e tyre rekomandimet e dhëna për efekt të përmirësimit të punës;

- ✓ Bazuar në ligjin për KLSH Bashkia raporton pranë këtij institucioni brenda 6 muajve nga dërgimi i tij dhe më pas KLSH kryen auditim tematik ku verifikon zbatimin e detyrave të lëna në raportin përfundimtar.

Faleminderit

Për Njësinë e Auditimit të Brendshëm

Afrim Beqiraj

KRYETARI I BASHKISË

GËZIM TOPÇIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ